



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë, më 10.03.2026

PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI
ME OBJEKT

LOTI I II-TË : “BLERJE USHQIME ME ORIGJINE SHTAZORE ”

**PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot me date 10.03.2026 ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit te ngritur me **urdherin nr.79 date 10.03.2026** , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar ”, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: Loti i II-të : “Blerje ushqime me origjine shtazore ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (Mish-15110000-2);(15511000-3-Qumesht)

VLERA E FONDIT LIMIT: 3’231’200(tre milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e dyqind)
lekë pa t.v.sh.

BURIMI I FINANCIMIT:Te ardhurat e Bashkise Kruje .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI I II-TË : “BLERJE USHQIME ME ORIGJINE SHTAZORE ”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; Ne raportin prej 2% te fondit limit te kontrates-lotit)

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2025 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2025 per secilin operator)*

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2025 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2025 per secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

b)Ofertuesi kandidat duhet të paraqesi licencën përkatëse(te vlefshme) të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit(kategoria II.1.A.1) për prodhim ose perpunim dhe shpërndarje me shumice të ushqimeve per njerëz, të produkteve objekt prokurimi.(te vlefshme sipas kërkesave ligjore ne fuqi) .

c)Përfashtim nga paraqitja e licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit bëjnë ato subjekte që kryejnë veprimtari me pakicë që nënkupton ato subjekte të regjistruara si pagues të takses vendore mbi biznesin e vogël dhe që sipas legjislacionit në fuqi nuk liçencohen., Ne rastin e subjekteve të cilët nuk janë subjekt licensimi sipas parashikimit **te pikes b** , si me siper(ne zbatim te VKM nr 538 date 26.05.2009 ”Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të liçencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” te kene te pasqyruar ne objektin e veprimtarise se QKB tregtimin e produkteve ushqimore.

Shenim- Per te permbushur kete kriter, **(piken 2.1.c)** ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM **Nr. 285, datë 19.5.2021** , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB., si dhe Rekomandimit nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.Gjithashtu nepermjet ketij kriteri i jepet hapesire edhe biznesit te vogel e te mesem te jete konkurues per proceduren perkatese te prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kërkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2022’2023’2024) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël

se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates/ **lotit nr.2(për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron)**).

Shenim-Pika 2.2-a) plotësohet duke paraqitur vërtetimin perkates te Administrates Tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43.2.c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë neëkohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nje kufiri te ulet dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operatoreve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3-1.a)Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates **me një vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit nr.2 (për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron)**, që prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë Krujë), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira/perdorim njësi tregtare/ambjente të përshtatshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës në të cilin tregton ose magazinon mallin që është objekt i **lotit nr. 2**, për të cilin duhet të paraqesë :

- Aktin e pronësisë të vlefshëm sipas legjislacionit në fuqi për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme, ose Kontratën e marrjes me qira/perdorim të objektit (të vlefshme për gjatë gjithë periudhës së parashikuar në afatin e levritimit të mallit) .
- Lejen higjieno-sanitare të objektit të vlefshme/aktin e miratimit higjienosanitar të vlefshëm, të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë në rrethet përkatëse (Inspektoriati/autoriteti kompetent që mbulon fushën e higjenes dhe shëndetit publik).
- Certifikatën e dizifektimit për ambientin përkatës të vlefshme për vitin 2026.

Shenim- Për të përmbushur këto kriter, në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM **Nr. 285, datë 19.5.2021**, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për arsye dinamizmit të kërkesës për ushqime, prandaj kopshteve dhe cerdheve të varesisë së Bashkisë Krujë të cilat janë të shtrira në një territor të gjërë, është e domosdoshme disponimi i një njesie tregtare /shitje/magazinimi nga ana e operatorit ekonomik me qëllim që të iu përgjigjet nevojave të Bashkisë Krujë në çdo kohë.

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare **dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.** Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5, 6 dhe 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, **kapacitetet teknike dhe profesionale**, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**”

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: ... **c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione**

2.3.3--Operatori ekonomik duhet provojë se furnizohet me artikujt perkates te **lotit nr. 2** nga nje ferme vendase/ thertore te licensuar sipas kushteve perkatese ligjore ne fuqi nga ana e organit kompetent, ose furnizohet nga importi sipas rregullave ligjore ne fuqi.Per te provuar kete pike operatori ekonomik duhe te paraqesi dokumentacionin perkates te vlefshem si vijon:

- Kontraten perkatese noteriale te furnizimit me firmen vendase/thertore (te vlefshme pergjate gjithe periudhes se realizimit kontrates)shoqeruar me dokumentacionin ligjor te pronesise se fermes ose aktin perkates te pronesis(te vlefshem) si dhe lejen perkatese te leshuar nga ana e autoritetit kompetent.
- Ne rast se vete subjekti ofertues e disponon nje ambient te tille ne pronesi, atehere duhet te paraqesi dokumentin perkates qe provon pronesin sipas ligjit shoqeruar me lejen perkatese per kete lloj ambienti te leshuar nga ana e autoritetit kompetent.

- Ne rastin e furnizimit nga importi duhet te paraqitet fatura tatimore perkatese ose akti i zhdoganimit shoqeruar me dokumentacionin ligjor shoqerues te artikujve qe provojne permbushjen e kerkeseve ligjore per importimin e ushqimeve ne Republiken e Shqiperise.

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të në zbatim të ligjit Nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin” (i ndryshuar), dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, referuar specifikës që kanë mallrat objekt prokurimi, **gjë që i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë të operatorëve ekonomikë, që ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke përmbushur standartet në fuqi për sigurinë ushqimore**, si dhe references se nenit 40.6 ku thuhet se ” *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:.” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.4: Operatori ekonomik duhet të disponojë te pakten një automjet te pershtatshem transporti (ATV) frigorifer, për transportin e mallit objekt prokurimi **te lotit nr 2**, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Aktin e pronësisë së mjetit përkatës ose Kontratën e marrjes me qera/perdorim të mjetit(te vlefshme per te gjithë periudhen e grafikut te levrimit te mallit objekt i kontrates(lotit nr.2) , te shoqeruara me dokumentacionin si me poshte vijon:
Për mjetet që shënohen në regjistra publikë/zyrtar duhet të paraqitet a).dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (**leje qarkullimi**)te vlefshme, b).**certifikaten e kontrollit teknik** te vlefshme dhe c).**siguracionin e mjetit** te vlefshme, **ndersa per mjetet e siguruar me qira/perdorim**, a).dokumenti qe verteton regjistrimin e tij(lejen e qarkullimit) te vlefshme, b). **certifikaten e kontrollit teknik** te vlefshme dhe c).siguracionin e mjetit (te vlefshme) .
- lejen higjieno sanitare perkatese te leshuar nga autoriteti kompetent(te vlefshme).

Shenim-Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenint 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të në zbatim të ligjit Nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin” (i ndryshuar), dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, referuar specifikës që kanë mallrat objekt prokurimi, **Rekomandimit nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Disponimii një automjet ATP në pronësi ose me qera, i cili do të shërbejë për transportin e mallrave objekt prokurimi, ku për vërtetimin e disponimit të tij duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë ose të marrjes me qira të mjetit, si dhe dokumentacionin sipas legjislacionin në fuqi për lejimin e qarkullimit të mjeteve.**Kushti i mësipërm ka lidhje të ngushtë me objektin e kontratës dhe është në përpjesëtim me objektin e kontratës. Njësia vlerëson se pa këtë mjet transporti një operator ekonomik nuk mund të realizoj furnizimin e mallrave të parashikuar në këtë prokurim.**

2.3.4- a)Kandidati /Ofertuesi duhet te paraqesi akt-kontrollin perkates te kryer nga AKU (te fundit) , qe verteton permbushjen e kerkesave tekniko teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit ushqimor.

b)Vetedeklarim nga ana e administratorit te shoqerise ofertuese se nga kontrolli i fundit i kryer nga ana e autoriteti kompetent per ushqimin dhe sigurine ushqimore, se aktiviteti qe ushtron permbush kerkesat e legjislacionit ne fuqi .

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenint 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të në zbatim të ligjit Nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin” (i ndryshuar), dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, referuar specifikës që kanë mallrat objekt prokurimi, vendosi që operatorët ekonomikë të paraqesin raport analizat e kryera për produktet e ofruara objekt prokurimi nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës, si dhe vetedeklarimin nga operatori ekonomik se ai përmbush standartet në fuqi për sigurinë ushqimore dhe se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se

ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore në fuqi, **gjë që i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë të operatorëve ekonomikë, që ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke përmbushur standartet në fuqi për sigurinë ushqimore**, si dhe references se nenit 40.6 ku thuhet se ” *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:...* **c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione**”

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.5-a) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizojë/transportojë dhe të mallrat objekt kontrate, në vendet e përcaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK deri në ezaurim të sasise së planifikuar edhe në rastin e tejkalimit të afatit 12 mujor nga data e nënshkrimit të kontratës, nëse ka sasi të pa ezauruar. (Deklarate të lëshuar nga Administratori i shoqërisë).

Argumentimi: Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponibilitet të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Hartimi i përgatitja specifikimeve teknike për artikujt e mësipërm është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Arsimit Kulturës dhe Sportit që mban **nr.1853 prot date 10.03.2026**, Ligjit Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, publikimeve të OBP (Organit të Blerjeve të Përqendruar), si dhe duke u nisur nga natyra e përdorimit të produkteve ushqimore si produkte ushqimore në përbërje të menusë së miratuar me Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, dhe Urdhërit nr. 457, datë 13.06.2018, Për një ndryshim të Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, Për specifikimet teknike janë marrë në konsideratë normat vijuese:

- Standardeve Shtetërore në fuqi STASH, për çdo artikull.
- Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar,
- VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”,
- Udhëzimin nr. 5, datë 25.03.2011 “Për kërkesat specifike të higjienës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumështi”,
- Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”.

- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”,
 - Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
 - Udhëzimin nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645 datë 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014 Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
 - Udhëzimin nr. 15, datë 09.09.2021 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “për Kriteret Mikrobiologjike për produktet ushqimore.
- **Fondi limit** per proceduren me objekt ,”**Loti nr.2-Blerje ushqime per kopeshtet dhe cerdhet e Bashkise Kruje, me natyre jo shtazore ‘**, eshte hartuar duke iu referuar cmimeve te tregut per kategorin e mallrave/artikujve te ngjashem ,sipas referimeve dhe metodave te parashikuara ne nenin 76.c te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK